



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Në çështjen juridike të:

AC-II-15-0042

I.T fshati, Malishevë,
Sh. MT me p.. **Av. A M**, Malishevë.

Paditësit

Kundër:

1.NB–“M”–“F”, fsh. Klinë.

Të paditurat/Ankuesit

Përfaqësuar nga **AKM-ja- Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. “Agim Ramadani” nr. 23.
Prishtinë.

2. Komuna Malishevës , Malishevë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami Gjyqtar Kryesues, Sabri Halili dhe Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e ankuesve të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, Malishevë, nr. C.nr. 29/2007 të datës 31 tetor 2007 dhe Aktgjykimit, Ac.nr.571/07 të datës 7 prill 2008 në seancën vendimmarrëse të mbajtur më 21/07/2020 lëshon këtë:

A K T V E N D I M

1. **Ankesa e AKM-së dhe AKP-së e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Malishevë C.nr.29/2007 të datës 31 tetor 2007 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac.nr. 571/07 të datës 07 prill 2008, hedhen poshtë si të papranueshme.**
2. **Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me datën 26.01.2007 paditësit përmes të autorizuarit të tyre, parashtruan padi në Gjykatën Komunale në Malishevë, ndaj të paditurave O M me seli në Malishevë dhe Komunës së Malishevës me te cilën kërkuan vërtetimin e pronësisë ,ndaj ngastrës kadastrale nr. 454/1 duke i propozuar gjykatës që pas vlerësimit dhe administrimit të gjitha provave kërkesëpadinë e paditësve të aprovon në tersi si të bazuar.

Paditësit pohuan se në vitin 1945 paraardhësit të tyre për shkak të veprimtarisë patriotike ishte dënuar me burg dhe prona, ngastra kadastrale nr. 454/1, vendi i quajtur “D” mal, klasi –II- dhe –IV- në sipërfaqe prej 40.00,00 ha. (më tutje prona kontestuese), zyra kadastrale, Banjë i është konfiskuar.

Ata pohuan se prona kontestuese tani gjendet si pjesë e ngastrës kadastrale nr.55 , fleta poseduese nr. 187, vendi “ D”, Zyra kadastrale B e cila evidentohet ne emër të N “ M “ Malishevë. Provë, dëgjimi i ndërgjygjësve dhe dëshmitarëve Q N T, I I Sh dhe H Z, Autorizim për përfaqësim, vendimi nr. 4529/12 i datës 1/11/1954, fleta poseduese nr. 187, si dhe një kopje të një flete poseduese pn. dhe kopja e planit.

Ata kërkuan që kërkesa e tyre të aprovohet si e bazuar, të vërtetohet se paditësit në bazë të trashëgimisë nga S T janë pronar të nr. 454/1, vendi i quajtur “D” mal, klasi –VI-në sipërfaqe prej 40.00,00 ha. fleta poseduese nr. 55 , zyra kadastrale B (më tutje prona kontestuese).

Me datën 01.10.2007 gjykata ka vërtetuar se trashëgimtar ligjor të paraardhësit të paditësit S T janë vet paditësit I dhe Sh T, në bazë të cilave gjykata e vërtetoi legjitimitetin aktiv të palëve paditëse .

Më 31/10/2007, Gjykata Komunale në Malishevë me Aktgjykim C.nr.29/2007, aprovoi kërkesë padinë e paditësve si në vijim:.. Paditësit në bazë të trashëgimisë nga paraardhësi i tyre i cili ka vdekur (gjyshi) S. T janë pronar të pronës kontestuese, ngastra kadastrale nr. 55 , fleta poseduese nr. nr. 187 sipërfaqes prej 40.000.00 ha.

Më 27/11/2007 e paditura e parë N “ M “ parashtroi ankesë, në Gjykatën e Qarkut ne Prizren kundër Aktgjykimit, C.nr.29/2007 të datës 31/10/2007 për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore konstatimit të gabuar të gjendjes faktike si dhe zbatimit te gabuar të së drejtës materiale. Ankuesja i propozoi Gjykatës anulimin e Aktgjykimit , C.nr.29/2007 të datës 31/10/2007 dhe kthimin e çështjes në DHPGJS.

Me datën 07.04.2008 Gjykata e Qarkut në Prizren, me Aktgjykim Ac.nr. 571/07 merr Aktgjykim me të cilin refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës O M nga Malisheva ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Malishevë C.nr.29/07 të datës 31.10.2007, vërtetohet.

Me 23 maj 2008 Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (me tutje AKM-ja) ka parashtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Malishevë C.nr.29/2007 të datës 31 tetor 2007 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.571/2007 të datës 7 prill 2007. Me ankesë AKM-ja kërkoi nga DHPGJS-ja që të anulohen të dy Aktgjykimet e sipër përmendura ndërsa lënda të rishikohet në DHPGJS si gjykatë me juridiksion parësor.

Me 16/09/2009 Agjencia Kosovare e Privatizimit (me tutje AKP-ja) ka parashtruar ankesë tjetër në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Malishevë C.nr.29/2007 të datës 31 tetor 2007 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.571/2007 të datës 7 prill 2007. Me ankesë AKP-ja kërkoi nga DHPGJS-ja që të anulohen të dy Aktgjykimet e sipër përmendura me arsyetim se Gjykatat nuk kane pasur juridiksion për të vendosur, ndërsa ndaj pronës së NSH –së në fjalë është duke u zhvilluar procedura e privatizimit. Provë, procesverbali i valës së 24 të privatizimit të NSH-ve si dhe Aktvendimi i DHPGJS së SCA-07-0030 i datës 20 nëntor 2007. Më 28/10/2009 paditësit në Gjykatën Komunale në Malishevë parashtruan propozimin për caktimin e masës së sigurisë , duke kërkuar nga Gjykata ndalimin e kundërshtarëve Xheladin Ramadan Shala, dhe Lutfi She Sh, lëvrimin e dhe mbjelljen me grurë në pronën kontestuese.

Në përgjigjën e vetë ndaj ankesës së AKP-së të datës 07/08/2012 përfaqësuesi i paditësve pohoi se Gjykata Komunale ka vepruar në kuadër të kompetencave të veta, Kjo dëshmohet edhe me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut i cili ka vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale . Për më tepër sipas paditësve ky Aktgjykim tashme është i formës së prerë dhe Ligji i DHPGJS-se i datës 01/01/2012 nuk ka efekt retroaktiv. Andaj ankesa e AKP-së duhet të refuzohet. Lënda evidentohet si SCA-08-0064.

Më 30/04/2008 paditësit në Gjykatën Komunale në Malishevë parashtruan propozimin për ekzekutimin e Aktgjykimit tashme të plotfuqishëm të Gjykatës Komunale Malishevë C.nr. 29/2007 të datës 31 /10/2007 tashme të vërtetuar edhe nga Gjykata e Qarkut Prizren Ac.nr, 571/07 të datës 07/04/2008.

Me datën 05.07.2012 Gjykata Komunale në Malishevë shpallet inkompetente në pikëpamje lëndore në çështje juridike të kreditorëve I dhe Sh T ng Komuna e Malishevës ndaj debitorëve N M në Malishevë lidhur me përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Malishevë C.nr.29/2007 i vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.571/07.

Pas plotfuqishmërisë së këtij Aktvendimit ,lënda komplet me të gjitha shkresat i dërgohet në kompetence DHPGJS-së në Prishtinë. Në DHPGJS, evidentohet si C-III-12-1340 dhe është lende aktive.

Me datën 03.12.2015 Gjyqtarja raportuese pas shqyrtimit të ankesës SCA-08-0064 të parashtruar nga ankuesit, lëshon Urdhër për Zyrën e Regjistrimit nëpërmjet të cilit kërkon që lënda të evidentohet për Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme. Lënda evidentohet si AC-II-15-0042.

Arsyetimi ligjor

Ankesat janë të papranueshme.

Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës sipas nenit 69.1 të Ligjit nr.06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit .

Ankesa e AKP-së me të cilën kërkon anulimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komonale në Malishevë C.nr. 29/2007 të datës 31 tetor 2007 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr. 571/07 të datës 07 prill 2008, nuk është e pranueshme sepse që të dyja Aktgjykimet janë të formës së prerë dhe detyruese.

Aktgjykimet apo Aktvendimet e formës së prerë sipas ligjit në fuqi, mund të atakohen vetëm me mjete të jashtëzakonshme juridike të goditjes. Në rastin konkret, ankesa e AKM-së-AKP-së nuk mund të interpretohet si çfarëdo mjeti i jashtëzakonshëm i pranueshëm, në bazë të përmbajtjes së saj, pasi që nuk ka përmbajtje të duhur që kërkohen për një mjet të tillë të goditjes.

Kjo ankesë nuk mund të trajtohet si kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, sepse një kërkesë të tillë, sipas ligjeve në fuqi, mund ta ngritë vetëm Prokurori i Shtetit (Neni 245 i LPK-së).

Kjo ankesë nuk mund të konsiderohet si kërkesë për rihapje të procedurave në mungesë të bazës së paraparë me nenin 232 të LPK-së. Në fund, parashtresa/ankesa e AKP-së nuk mund të konsiderohet si revizion me çfarëdo mundësie për të pasur sukses për shkak se nuk janë dhënë bazat e cekura në Nenin 214.4 në lidhje me nenin 194 dhe 182 të LPK-së.

Përkundër fakti se AKP-ja, në ankesën e vetë para DHPGJS-së e ka ngritur çështjen e mungesës së Juridiksionit të Gjykatave të rregullta për nxjerrjen e Aktgjykimeve të ankimuara kur objekti i kontestit përfshihet në Juridiksionin e DHPGJS-së (neni 4) dhe palë e paditur është Ndërmarrja Shoqërore (neni 5). Kolegji i Apelit vlerëson se neni 4.4 i Ligjit për Dhomën e Posaçme (LDHP-së) i cili ka hyre në fuqi më 01 01/2012, nuk ka efekte retroaktive ndaj Aktgjykimeve apo Aktvendimeve të plotfuqishme të lëshuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

Kjo situatë ligjore e cekur, ngjashëm është rregulluar edhe me nenin 5.4 të LDHP-së nr.06/L-086 i cili ligj tashmë është në zbatim. Rasti në fjale është i tillë. Prandaj si është vendosur tani më, nga jurisprudenca e Kolegjit të Apelit (AC-II-14-0015) këtë Ankesë duhet të hedhur poshtë si të pa pranueshme.

Aktgjykimet dhe Aktvendimet e formës së prerë të nxjerra para hyrjes në fuqi të nenit 4.5.1. e LDHP-së të vitit 2012, nuk duhet të konsiderohen nulë dhe pa efekte juridike, edhe nëse janë

nxjerrë për rastet që bien në kompetencë të Dhomës së Posaçme. Zgjidhje të njëjtë parasheh edhe Ligji i ri nr.06/L-086 në zbatim nga datat 17 korrik 2019.

Lidhur me pyetjen e vendimeve të nxjerra nga gjykatat kompetente, sistemet ligjore në përgjithësi përgjigjen duke u thirrur në parimin e sigurisë ligjore me vërtetim të plotfuqishmërisë së Aktgjykimit ('res judicata'), që mbulon dhe rregullon të gjitha format e parregullsive të shkaktuara si pasojë e mungesës së juridiksionit.

Edhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut e ka inkorporuar këtë arsyetim në koncept të së drejtës për gjykim të drejtë. Në Aktgjykimin e rastit të XHERAJ v. ALBANIA (Kërkesa nr. 37959), e datës 29.07.2008, thuhet si në vijim:

Gjykata rithekson se në përputhje me preambulën e Konventës, sundimi i ligjit është pjesë e trashëgimisë së përbashkët e Shteteve Kontraktuese, një nga aspektet themelore e së cilës është parimi i sigurisë juridike, që ndër të tjerash kërkon se kur gjykatat kanë vendosur përfundimisht një çështje, aktvendimi i tyre nuk duhet të vihet në pikëpyetje (shih *Brumărescu v. Rumania* [GC], nr. 28342/95, § 61, ECHR 1999 VII).

Për më tepër, Gjykata vëren se kushtet e sigurisë ligjore nuk janë absolute. Shmangia nga ky parim justifikohet vetëm nëse ka qenë e domosdoshme të bëhet si rezultat i rrethanave të një karakteri thelbësor dhe detyrues (*Ryabykh k. Rusi*, nr. 52854/99, § 52, ECHR 2003 IX) ose nëse vlerësimet serioze legjitime janë më të rëndësishme sesa parimi i sigurisë juridike (shih *Bratyakin v. Rusi* (dhjetor), nr. 72776/01, 9 mars 2006).

Dhe ne mund të gjejmë ritheksimin e kësaj deklaratë në rastet e *Sovtransavto Holding v. Romani* (Kërkesa nr. 48553, 25.07.2002), *Androne v. Romani* (Kërkesa nr. 54062/00, 22.12.2004) dhe *SC Plastick ABC SA v. Ukrainë* (Kërkesa nr. 32299, 7.02.2008).

Në fakt Kushtetuta e Republikës së Kosovës shprehimisht përcakton në nenin e saj 22 se të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore të garantuara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në Republikën e Kosovës 'dhe në rast konflikti kanë prioritet ndaj dispozitave të ligjit'.

Shtrohet pyetja në rast se Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) ose Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) mungon në procedurat gjyqësore, a e ndalon një gjë e tillë Kolegjin e

Ankesave që ta konsiderojë Aktgjykimin si të formës së prerë. Përgjigja ndaj kësaj pyetje është jo.

Megjithatë Kolegji i Apelit ka vërejtur se në procedurat para Gjykatës Komunale në Malishevë NSH-ja është paraqitur në procedurë dhe e ka parashtruar ankesën ndaj Aktgjykimi të Gjykatës Komunale në Malishevë C.nr.29/2007 të datës 31 tetor 2007, e cila ankesë ishte e refuzuar nga Gjykata e Qarkut në Prizren me Aktgjykimin Ac.nr.571/07 të datës 07 prill 2008, dhe ishte vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Malishevë .

Ky rezultat i dhënë nga gjykatat e rregullta tashmë është përfundimtar. Ish AKM-ja në fazën e procedurës ankimore megjithatë ishte palë në procedurë, por ajo nuk ishte e suksesshme me ankesën e saj. Andaj Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren tashmë është i formës së prerë dhe detyrues për palët e përfshira në procedurë.

Agjencia (AKM-ja ose AKP-ja) sipas neneve 1, 2, 6 dhe 7 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12, dhe Ligjit 03/L-067 dhe Ligjit 04/L-033, është organ i pavarur publik me kompetenca për të administruar (që përfshin shitjen, transferimin dhe likuidimin) ndërmarrjet në pronësi shoqërore (NSH) apo asetet, por kompetencat e saj administrative nuk përjashtojnë autonominë, zotësinë juridike dhe menaxhimin e ndërmarrjeve nën administrimin e saj.

Agjencia është e autorizuar që të ndërhyjë fuqishëm në menaxhimin e NSH-së por nuk e zëvendëson atë; nuk e inkorporon atë. Ato megjithatë, janë subjekte të ndryshme autonome, edhe pse brenda vetes janë të ndërlidhura. Në fakt ligji përcakton një sërë dispozitash për të siguruar që Agjencia të jetë në dijeni për çështjet gjyqësore në të cilat është e përfshirë NSH-ja; domosdoshmërinë e njoftimit paraprak lidhur me qëllimin e ushtrimit të ndonjë veprimi juridik (neni 29 i ligjit për AMK-në/ AKP-në), pa e diskutuar tani nëse kjo dispozitë mbetet pas 1.10.2012 me hyrjen në fuqi të Ligjit për Dhomën e Posaçme); nga gjykata kërkohet që të emërojë Agjencinë si palë (sipas nenit 4.4 (tani 5.4) të Ligjit për Dhomën e Posaçme). Mirëpo bërja me dije vetëm ia jep mundësinë Agjencisë që të mos e zëvendësojë por ‘të veprojë në emër të saj’ (shih nenin 5.2.2 (tani 6.2.2) të Ligjit për Dhomën e Posaçme dhe nenin 29.2 të Ligjit për AKP-në) si ‘përfaqësues ligjor’ (shih nenin 29.3 të Ligjit për AKP-në) i NSH-së.

Si rrjedhojë, raporti midis NSH-së dhe Agjencisë duhet të konsiderohet si i brendshëm. Agjencia dhe NSH-ja janë dy anët e së njëjtës monedhë. Prandaj, pjesëmarrja e njëres prej

tyre në procedura gjyqësore është e mjaftueshme që të merret parasysh në përputhje me të drejtën për t'u dëgjuar, të drejtën për gjykim të drejtë. Mungesa e Agjencisë për të intervenuar nuk e vë në dyshim plotfuqishmërinë e Aktgjykimit. Aktgjykimi i plotfuqishëm për rastin kur vetëm NSH-ja ose Agjencia kanë qenë palë, është Aktgjykim detyruës për të dyja, si për NSH-në ashtu edhe për Agjencinë. Ky ka qenë edhe konkluzioni i gjykatës në disa aktgjykime tjera, që do të thotë në aktgjykimet e datave 20.09.2012 (rasti SCPL-10-0001), 7.03.2013 (rasti AC-II-12-0212) dhe 28.06.2013 (rastet SCA-08-0040 dhe SCA-08-0038).

Andaj në bazë të arsyeve të cekura dhe nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Taksat gjyqësore:

Nuk caktohen tasat gjyqësore për procedurën ankimore, sepse plani i miratuar i taksave gjyqësore të DHPGJS-së, i cili ka hyrë në fuqi më 27 mars 2014, nuk mund të zbatohet në mënyrë retroaktive për lëndët në pritje.

U vendos nga Kolegji i Ankesave në DHPGJS, më 21/07 / 2020

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues
